



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Nr. _____ Prot

Korçë, më 03.04.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (paraparak)

Date 03.04.2023

Drejtuar: *Shoqërisë “Zeqillari” shpk* adresa: *Tiranë, Njësia Nr.5, Komuna e Parisit, Rruga “Osman Myderizi”, Zona Kadastrale 8270, Nr.Pasurie 6/426-N8*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur**

Numri i procedurës **REF-60961-03-01-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **“Qendra e Kreativitetit faza II”**

Afati: **2 muaj**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : **Date 06.03.2023, Nr.21**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatoreve Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company shpk NIPT L04803001U(Degë e shoqërisë të huaj RSM Company Nr 810802422) dhe “ DESARET COMPANY ” NIPT K01816001J me vleren:

13.270.123 (trembedhjetë milion e dyqind e shtatedhjetë mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë, pa tvsh

2. Shoqëria “ ZEQILLARI ” shpk, NIPT L619120240 me vleren:

13.630.831,4 (trembedhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e teteqind e tridhjetë e një, presje kater) lekë pa tvsh.

3. Shoqëria “ NIKA ” shpk, NIPT J76705047U me vleren:

14.006.586,88 (katermbedhjetë milion e gjashtë mijë e pesëqind e tetedhjetë e gjashtë, presje tetedhjetë e tete) lekë pa tvsh.

4. Shoqeria “ INA ” shpk, NIPT J61814009W me vleren:

14.662.067 (katermbedhete milion e gjashteqind e gjashtedhete e dy mije e gjashtedhete e shtate) lekë pa tvsh

5. Shoqeria “ ASI -2A CO ” shpk, NIPT K53002402C me vleren:

14.696.772,4 (katermbedhete milion e gjashteqind e nentedhete e gjashte mije e shtateqind e shtatedhete e dy, presje kater) lekë pa tvsh.

6. Shoqeria “ INFINIT ” shpk, NIPT J74304623M me vleren:

16.469.953,68 (gjashtembedhete milion e katerqind e gjashtedhete e nente mije e nenteqind e pesedhete e tre, presje gjashtedhete e tete) lekë pa tvsh.

7. Shoqeria “ GLAVENICA ” shpk, NIPT K17710805A me vleren:

16.545.293 (gjashtembedhete milion e peseqind e dyzet e pese mije e dyqind e nentedhete e tre) lekë pa tvsh.

8. Shoqeria “ XHENGO ” shpk, NIPT J64103171M me vleren:

17.398.918 (shtatembedhete milion e treqind e nentedhete e tete mije e nenteqind e tetembedhete) lekë pa tvsh.

Nga pjesërmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatoreve Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company shpk NIPT L04803001U(Degë e shoqerise te huaj RSM Company Nr 810802422) dhe “ DESARET COMPANY ” NIPT K01816001J ,per arsye se:

1. Ofertuesi nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.6 ku përcaktohet shprehimisht se :

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;**

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Konkretisht shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k (degë e shoqërisë së huaj RSM COMPANY) nuk ka dorëzuar dokumentacion që të vërtetojë se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit sipas përcaktimeve të bëra më sipër dhe në përputhje me përqindjen dhe punimet konkrete që ka marrë përsipër në Kontratën e bashkëpunimit.

Kontrata me objekt Asfaltimi i rrugës Dol-Kusar-Goden-,Gjakove,Faza e II-të e zbatuar nga shoqëria RSM COMPANY sh.p.k nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit.

2. Bazuar në kontratën e bashkëpunimit shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k, me NIPT L04803001U është caktuar si përfaqësuese e bashkimit të shoqërive “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k dhe “Desaret Company” sh.p.k , ku ndër të tjera është caktuar që të bëjë aplikimin për procedurën e prokurimit dhe ndjekjen e procedurave online. Për sa më sipër mbështetur , në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” dhe në autorizimin e bërë para noterit datë 30.12.2022, është shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k, me NIPT L04803001U, ajo e cila duhet duhet të kishte aplikuar në APP (www.app.gov.al) për këtë procedurë prokurimi.

2. Shoqëria “INFINIT” shpk, per arsye se:

Ofertuesi nuk plotëson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.6 ku përcaktohet shprehimisht se :

2.2.6 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte :

- Çertifikaten ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit te cilesise”
- Çertifikaten ISO 14001: 2015 Per menaxhim mjedisi
- Çertifikaten ISO 45001-2018 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

- Konkretisht ofertuesi ka paraqitur Çertifikaten ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit te cilesise”, Çertifikaten ISO 14001: 2015 Per menaxhim mjedisi, Çertifikaten ISO 45001-2018 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”.

Nga verifikimi i bere ne adresen www.rigcert.org, dhe nëpërmjet emailit në adresën zyrtare te kompanise “Rigcert” rezultoi se keto certifikata kane statusin “Withdrawn”, pra nuk rezultojnë aktive dhe si rrjedhim nuk janë te vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerine **“Zeqillari”shpk me adresë: Tiranë, Njësia Nr.5, Komuna e Parisit, Rruga “Osman Myderizi”, Zona Kadastrale 8270, Nr.Pasurie 6/426-N8**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **13.630.831,4** (*trembedhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e një, presje kater*) lekë pa tvsh është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**